



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 43	2001	Gusht
--------	------	-------

P Ë R M B A J T J A

Vendim i KM nr.489, datë 14.8.2001	Për disa shtesa në vendimin nr.500, datë 21.9.2000 të Këshillit të Ministrave “Për njësitë e shoqërisë “Armo”, sh.a., që nuk do të vlerësohen si pjesë të sektorëve me rëndësi të veçantë”.....	1355
Vendim i GJL nr.2, datë 19.4.2001	Për të pandehurit Altin Luzi, Agron Hajdari dhe Gazmir Xhaferri	1355
Vendim i GJL nr.85, datë 29.6.2001	Me objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Kthimit të Pronave nr.204, datë 4.11.1994	1361
Vendim i GJK nr.78, datë 16.7.2001	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 012, datë 1.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr. 13 Lezhë	1367
Vendim i GJK nr.79, datë 18.7.2001	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.158, datë 10.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	1370
Vendim i GJK nr.87, datë 11.7.2001	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.956, datë 29.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe deklarimin të pavlefshme të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.5 Shkodër.....	1372

Vendim i GJK
nr.93, datë 23.7.2001

Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.163, datë 17.7.2001 të
Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe shpalljen e
pavlefshmërisë së zgjedhjeve në këtë zonë..... 1373

V E N D I M
Nr.489, datë 14.8.2001

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.500, DATË 21.9.2000, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR NJËSITË E SHOQËRISË “ARMO” SH.A., QË NUK DO TË
VLERËSOHEN SI PJESË TË SEKTORËVE ME RËNDËSI TË VEÇANTË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe nenit 1 të ligjit nr.8582, datë 23.2.2000 “Për një shtesë në ligjin nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.500, datë 21.9.2000 të Këshillit të Ministrave, në listën e njësive të cilat nuk do të vlerësohen si pjesë të sektorëve me rëndësi të veçantë, pas numrit 28 shtohen:

- “29. Dega e karburanteve, Kavajë.
- 30. Dega e karburanteve, Korçë.
- 31. Pika e shitjes me pakicë e karburanteve, e Fermentimit Shkodër.
- 32. Pika e shitjes me pakicë e karburanteve, Korçë.
- 33. Pika e shitjes me pakicë e karburanteve, Peqin.
- 34. Shtypshkronja, Kuçovë.
- 35. Briketimi, Ballsh.
- 36. Depoja e gazit të lëngshëm, Ballsh.”.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.2, datë 19.4.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbërë nga :

Thimjo Kondi	Kryesues i Gjykatës së Lartë
Bashkim Caka	Anëtar i“““
Nikoleta Kita	Anëtar i“““
Valentina Kondili	Anëtare e “““
Ylvi Myrtja	Anëtare e “““
Natasha Sheshi	Anëtare e “““
Kristaq Ngjela	Anëtar i“““
Artan Hoxha	Anëtar i“““
Zamir Poda	Anëtar i“““
Tefta Zaka	Anëtare e “““
Vladimir Metani	Anëtar i“““
Metush Saraçi	Anëtar i“““

në seancën gjyqësore të datës 19.4.2001, morën në shqyrtim çështjen penale me nr.390 Akti që i përket:

Të pandehurve:Altin Luzi

Akuza: Vjedhje me pasojë vdekjen e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 141 dhe

25 të Kodit Penal. Plagosje e lehtë me dashje e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 89 dhe 25 të Kodit Penal. Vjedhje me dhunë, parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal. Mbajtje pa leje e armëve luftarake, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal.

Agron Hajdari

Akuza: Vjedhje me pasojë vdekjen e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 141 dhe 25 të Kodit Penal. Plagosje e lehtë me dashje e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 89 dhe 25 të Kodit Penal. Vjedhje me dhunë, parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal. Mbajtje pa leje e armëve luftarake, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal.

Gazmir Xhaferri

Akuza: Mbajtje pa leje e armëve luftarake, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës, me vendimin nr.172, datë 23.3.1999 ka vendosur:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit Agron Hajdari për veprat penale të vrasjes me dashje, në lidhje me një krim tjetër, në bazë të nenit 77 të Kodit Penal; të vjedhjes me dhunë të mbetur në tentativë të kryer në bashkëpunim ndaj shtetasit Xhemal Caka, në bazë të nenit 139, 22 dhe 25 të Kodit Penal; të vjedhjes me dhunë të policit Zog Lika, në bazë të nenit 139 të Kodit Penal, të plagosjes së lehtë me dashje, në bazë të nenit 89 të Kodit Penal dhe në aplikim të nenit 51 dhe 55 të Kodit Penal e ka dënuar përfundimisht me 12 vjet e 6 muaj burgim.

2. Deklarimin fajtor të të pandehurit Altin Luzi për veprat penale të vjedhjes me dhunë ndaj shtetases Nadire Shatlari dhe të policit Shkëlqim Sula, në bazë të nenit 139 të Kodit Penal; të vjedhjes me dhunë të mbetur në tentativë të kryer në bashkëpunim ndaj shtetasit Xhemal Caka, në bazë të nenit 139, 22 dhe 25 të Kodit Penal; të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, në bazë të nenit 278/2 të Kodit Penal dhe në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal dhe 406/1 të Kodit të Procedurës Penale e ka dënuar përfundimisht me 8 vjet burgim.

3. Deklarimin fajtor të të pandehurit Gazmir Xhaferri për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, në bazë të nenit 278/2 të Kodit Penal dhe në aplikim të nenit 51 të këtij Kodi e ka dënuar me kohën e qëndrimit në “arrest shtëpie”.

Gjykata e Apelit të Tiranës, mbi ankimin e të pandehurit Agron Hajdari, me vendimin nr.246, datë 20.9.1999, ka vendosur:

Lënen në fuqi të vendimit nr.172, datë 23.3.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës.

Kundër vendimit të gjykatës së apelit kanë bërë rekurs i gjykuari Agron Hajdari dhe prokurori duke parashtruar këto shkaqe:

Prokurori:

Ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale nga gjykata nga neni 141 në nenin 77 të Kodit Penal për të pandehurit Agron Hajdari dhe Altin Luzi është bërë në aplikim të gabuar të ligjit dhe nuk është mbështetur në asnjë provë tjetër, përveç atyre që ka marrë prokuroria në fazën e hetimeve paraprake. Ky ndryshim është bërë gjithashtu në kundërshtim me nenin 372 të Kodit të Procedurës Penale pa dijeninë dhe pëlqimin e të pandehurve dhe të avokatëve.

Prokurori i shkallës së parë, në kundërshtim me ligjin, ka tërhequr akuzën për vjedhje me pasojë vdekje të viktimës Xhemal Caka për të pandehurin Altin Luzi dhe, për këtë, ka dënuar të pandehurin Agron Hajdari, duke ia ndryshuar cilësimin juridik të veprës, në vrasje me dashje në lidhje me një krim tjetër.

I gjykuari Agron Hajdari:

Jam i pafajshëm për vrasjen e viktimës Xhemal Caka. Të gjitha provat flasin se këtë vepër e ka kryer i pandehuri Altin Luzi. Edhe i pandehuri Gazmir Xhaferri ka pohuar se vrasjen e ka kryer i pandehuri Altin Luzi. Automatikisht me të cilin është realizuar vrasja është gjetur në shtëpinë e të pandehurit Altin Luzi.

Gjykimi i të pandehurit Agron Hajdari është bërë në mungesë, pa u njoftuar më parë ai, sikurse parashikon neni 139 dhe 142 i Kodit të Procedurës Penale, dhe pa u bërë shpallja e mungesës. Për këtë shkak, është kërkuar që të përsëritet shqyrtimi gjyqësor në apel, sipas kërkesave të nenit 427 të Kodit të Procedurës Penale, gjë që padrejtësisht nuk u pranua nga gjykata. Vetë gjykata e apelit ka pranuar se vrasja e viktimës Xhemal Caka është kryer në bashkëpunim, por në qoftë se çështja ka ardhur me ankimin tim është mjaftuar me vërejtje, duke më lënë kështu në ngarkim padrejtësisht dhe në mënyrë haptazi të palogjikshme vrasjen e viktimës Xhemal Caka.

Në gjykimin në shkallë të parë me rastin e ndryshimit të akuzës nuk na është krijuar nga gjykata mundësia dhe e drejta për t'u mbrojtur, pasi në kundërshtim me nenet 372 dhe 376 të Kodit të

Procedurës Penale, nuk na u dha kohë për të paraqitur pretendimet tona.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjuan relacionin përkatës, prokurorin e seancës Mihallaq Bleta, i cili kërkoi prishjen e vendimeve dhe kthimin e akteve për rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë, mbrojtësin e të gjykuarit Altin Luzi, avokatin Bashkim Haxhi, i cili kërkoi të lihet në fuqi vendimi i gjykatës së apelit, mbrojtësin e të gjykuarit Agron Hajdari, avokatin Shefqet Muçi, i cili kërkoi të prishen të dy vendimet dhe çështja të kthehet për rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë dhe pasi shqyrtuan çështjen në tërësi,

V Ë R E J N Ë:

Të dy vendimet gjyqësore janë marrë në zbatim të gabuar të dispozitave procedurale e, për këtë shkak, ato duhet të prishen.

Me vendimin nr.172, datë 23.3.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës, është deklaruar fajtor i pandehuri Agron Hajdari për veprat penale si më sipër dhe, në aplikim të nenit 51 dhe 55 të Kodit Penal, është dënuar përfundimisht me 12 vjet e 6 muaj burgim; deklaruar fajtor i pandehuri Altin Luzi për veprat penale të vjedhjes me dhunë, parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal, të vjedhjes me dhunë të mbetur në tentativë të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 139, 22 dhe 25 të Kodit Penal dhe për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, parashikuar nga neni 278/2 të Kodit Penal dhe, në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal dhe 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, është dënuar përfundimisht me 8 vjet burgim; deklaruar fajtor i pandehuri Gazmir Xhaferri për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, parashikuar nga neni 278/2 të Kodit Penal dhe është dënuar me kohën e paraburgimit.

Kundër këtij vendimi, ka bërë ankim në Gjykatën e Apelit të Tiranës i pandehuri Agron Hajdari. Në përfundim të gjykimit, gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke i tërhequr vëmendjen asaj gjykate për aplikim të gabuar të ligjit penal. Sipas saj kanë qenë kushtet që të pandehurit Agron Hajdari dhe Altin Luzi të përgjigjeshin për veprën penale të vjedhjes me pasojë vdekje, parashikuar nga neni 141 i Kodit Penal, ndërkohë që ata janë deklaruar fajtorë për veprën penale të vjedhjes me dhunë. Gjykata, duke marrë për bazë faktin që ankimi kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë është bërë nga njëri prej të pandehurve dhe se pozita e tyre nuk mund të rëndohet, me të drejtë, ka konstatuar shkeljen dhe është mjaftuar me tërheqjen e vëmendjes asaj gjykate për aplikim të gabuar të ligjit.

Në Gjykatën e Lartë, përveç ankimit të të pandehurit Agron Hajdari, lidhur me pretendimet që ai ngre për drejtësinë dhe bazueshmërinë e vendimeve të mësipërme të gjykatave, ka bërë rekurs edhe prokurori, i cili, duke marrë shkas edhe nga vendimi i Gjykatës së Apelit të Tiranës, ka kërkuar prishjen e vendimeve të gjykatave për të tre të pandehurit dhe kthimin e çështjes në shkallë të parë, për shkak të cilësimit juridik të gabuar të veprës. Organi i prokurorisë e konsideron ndryshimin e cilësimit juridik të veprës nga vjedhje me pasojë vdekjen, parashikuar nga neni 141 i Kodit Penal, në vjedhje me dhunë mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 139 dhe 22 i Kodit Penal, si të pambështetur në ligj dhe në prova. Me fjalë të tjera, sipas rekursit të prokurorit, në themel kërkohet që pozita e të pandehurve në rigjykim të rëndohet.

Kolegji Penal ia ka kaluar çështjen për shqyrtim Kolegjeve të Bashkuara, me qëllim unifikimin e praktikës gjyqësore lidhur me kufijtë e shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë kur ankimi për një çështje në gjykatën e apelit është bërë vetëm nga i pandehuri, ndërsa në Gjykatën e Lartë rekurs është paraqitur si nga i gjykuari, ashtu edhe nga prokurori ose vetëm nga ky i fundit.

Kolegjet e Bashkuara, për të arritur në përfundimet e tij, mori në konsideratë ndër të tjera edhe nenin 2 të Protokollit 7 të Konventës Evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut” dhe nenin 43 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nga ku rezulton se personi i deklaruar fajtor për një vepër penale ka të drejtë të paraqesë ankim në një gjykatë më të lartë në kushtet që parashikon ligji.

Kushtet që parashikon ligji, sipas të drejtës sonë, janë të përcaktuara në Titullin VIII të Kodit të Procedurës Penale, i cili rregullon ankimet ndaj vendimeve gjyqësore, mënyrën, procedurën, si dhe kufijtë e shqyrtimit të tyre. Ndër të tjera, ligjvënësi ka përcaktuar një garanci procedurale të

rëndësishme për të pandehurin kur i garanton atij të drejtën e një apeli, pa patur rrezikun e rëndimit të pozitës me ushtrimin e kësaj të drejte. Kështu, në nenin 425 pika 2 të këtij Kodi është parashikuar se “kur apelues është vetëm i pandehuri, gjykata nuk mund të caktojë një dënim më të rëndë, të zbatojë një masë sigurimi më të rëndë, t’i japë pafajësisë një shkak më pak të favorshëm nga ai i vendimit të apeluar”. Ndërsa në pikën 3, përcakton se, kur apelues është edhe prokurori ose vetëm ky i fundit, gjykata e apelit “mund t’i japë faktit një cilësim juridik më të rëndë, të ndryshojë llojin ose ta rrisë masën e dënimit”.

Në kuptim të kësaj dispozite, gjykata e apelit, kur shqyrton çështjen vetëm mbi ankimin e të pandehurit, në asnjë rast nuk mund të rëndojë pozitën e tij lidhur me masën e dënimit, ashtu edhe për cilësimin juridik të veprës, nga një vepër penale më të lehtë në një më të rëndë.

Kodi i Procedurës Penale, në të njëjtin titull, parashikon gjithashtu të drejtën e palëve të ushtrojnë rekurs në Gjykatën e Lartë kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në kuptim të nenit 432 të Kodi i Procedurës Penale, rekursi lejohet vetëm për shkaqe të kufizara që lidhen me mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material ose normave procedurale, të cilat e bëjnë vendimin e dhënë të kundërligjshëm. Nga kjo, rezulton se shkelja e ligjit nga gjykatat më të ulëta në dhënien e vendimeve i jep juridiksion Gjykatës së Lartë të shqyrtojë edhe të cenojë vendimet e tyre.

Kolegjet e Bashkuara pranojnë se, në dallim nga neni 425 i Kodi i Procedurës Penale, neni 434 të këtij Kodi detyron Gjykatën e Lartë të shqyrtojë çështjen brenda shkaqeve të ngritura në rekurs, si dhe mund të vendosë edhe për çështje të tjera ligjore për të cilat gjykatat duhet t’i kishin parë kryesisht. Nga kjo rezulton se Gjykata e Lartë ka detyrimin ligjor që, kur konstaton se gjykatat e shkallëve më të ulëta kanë gabuar në zbatimin e ligjit në dhënien e vendimeve të tyre, t’i prishë ato dhe të disponojë në një nga mënyrat që përcakton neni 441 i Kodi i Procedurës Penale.

Duke analizuar sa më sipër, arrihet në përfundimin se kufijtë e shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë lidhen vetëm me shkaqet ligjore të ngritura apo të konstatuara, që e bëjnë vendimin e ankimit të kundërligjshëm, në dallim me gjykimin në apel, ku kufijtë e shqyrtimit të çështjes në atë gjykatë lidhen edhe me subjektin që ka ushtruar të drejtën e ankimit.

Duke pranuar faktin se Gjykata e Lartë e shikon çështjen nga pikëpamja e shkeljeve të ligjit, ligjvënësi nuk i ka vënë kufizime asaj, ashtu sikurse ka vepruar për gjykatën e apelit në lidhje edhe me palën që ushtron ankimin. Kolegjet e Bashkuara çmojnë se Gjykata e Lartë nuk kufizohet në shqyrtimin e çështjes, lidhur me konstatimin e paligjshmërisë së vendimit gjyqësor të formës së prerë. Ashtu sikurse palët kanë të drejtë të bëjnë ankim në gjykatën e apelit, po ashtu ligji parashikon edhe të drejtën e tyre për të bërë rekurs në Gjykatën e Lartë.

Fakti që prokurori nuk ka ushtruar ankim në gjykatën e apelit ndaj vendimit të dhënë nga gjykata e shkallës së parë, nuk i mophon atij të drejtën të bëjë rekurs në Gjykatën e Lartë. Në rast të kundërt, ligji duhet të shprehë në mënyrë eksplicite lidhur me humbjen e kësaj të drejte. Në Kodin e Procedurës Penale nuk gjendet asnjë dispozitë që të shprehë për humbjen e të drejtës për t’iu drejtuar një gjykate më të lartë, kur nuk është ushtruar e drejta e ankimit në një gjykatë më të ulët. Me fjalë të tjera, mosushtrimi i së drejtës së apelit nuk do të thotë mohim i të drejtës për të ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë për ato shkaqe që parashikon neni 432 i Kodit të Procedurës Penale.

Ligji, gjithashtu, nuk ka vënë kufizime lidhur me ushtrimin e kësaj të drejte nga palët në raporte të diferencuara me njëra-tjetrën, por këtë të drejtë ua njeh atyre në mënyrë të barabartë. Nga ana tjetër, sipas nenit 148 pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, organi i prokurorisë është një organ i centralizuar. Kodi i Procedurës Penale parashikon në nenin 24 pika 4 të tij që “urdhrat dhe udhëzimet e prokurorit më të lartë janë të detyrueshme për prokurorin më të ulët”, ndërsa në nenin 25 pika 2 përcakton se “në seancë gjyqësore prokurori ushtron funksionet e tij me pavarësi të plotë”. Po ashtu, e drejta e prokurorit më të lartë për të ushtruar ankim ndaj një vendimi gjyqësor nuk është e lidhur me qëndrimin që është mbajtur nga prokurori më i ulët, sikurse parashikon neni 408 i Kodit të Procedurës Penale.

Kolegjet e Bashkuara, nga sa referohet më sipër, arrijnë në përfundimin se e drejta e ushtrimit të ankimit ndaj vendimeve gjyqësore nga prokurori më i lartë nuk kufizohet nga qëndrimi që ka mbajtur prokurori më i ulët. Nisur nga ky përfundim, lidhur me çështjen konkrete, megjithëse prokurori më i ulët nuk ka bërë ankim ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, nuk i mophon të drejtën prokurorit të apelit që të ushtrojë rekurs në Gjykatën e Lartë.

Konstatimi i paligjshmërisë së vendimeve gjyqësore nga Gjykata e Lartë, edhe kur është në disfavor të të gjykuarit, nuk lidhet me rëndimin e pozitës së tij, kur shkakun për prishjen e vendimit

është aplikimi i gabuar i ligjit që passjell pavlefshmëri të vendimit të ankimuar.

Në favor të këtij përfundimi është edhe fakti që asnjë dispozitë e Konventës Evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut” apo e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë nuk parashikon një garanci të tillë. E vetmja garanci e parashikuar për të pandehurin, lidhur me mosrëndimin e pozitës së tij, është ajo e nenit 425 të Kodit të Procedurës Penale, kur çështja në gjykatën e apelit shqyrtohet mbi ankimin e të pandehurit.

Sa më sipër, arrijmë në përfundimin se Kodi ynë i Procedurës Penale bazohet në parimin e barazisë së palëve, ku në nenin 407 të tij, parashikonin mjetet e ankimit kundër vendimeve gjyqësore të cilat janë apeli, rekursi në Gjykatën e Lartë dhe kërkesa për rishikim. Secili pjesëmarrës në procesin penal, si i pandehuri, prokurori dhe i dëmtuari akuzues për veprat penale që ndiqen mbi ankimin e këtij të fundit, mund të ushtrojnë, në mënyrë të pavarur dhe të pakushtëzuar nga njëri-tjetri, cilindo mjet ankimi të parashikuar në dispozitën e sipërpërmendur, në përputhje me kriteret e përcaktuara për ushtrimin e tyre.

Konkuzionet e mësipërme për unifikimin e praktikës gjyqësore përforcohen më tej, duke analizuar shkakun ligjor të prishjes së vendimeve gjyqësore për çështjen në shqyrtim. Nga aktet e ndodhura në dosje, rezulton se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës është marrë në kundërshtim të hapur me kërkesat e Kodit të Procedurës Penale, lidhur me gjykimin në mungesë. Kështu, nuk rezulton që të jetë bërë njoftimi për të gjykuar Agron Hajdari i Kodit të Procedurës Penale, ashtu sikurse përcakton neni 141. Gjithashtu, nuk rezulton që të jetë bërë deklarimi i mungesës së tij konform kërkesave të nenit 141 pika 1 dhe 2 të Kodit të Procedurës Penale. Këto shkelje, në kuptim të nenit 128 të Kodit të Procedurës Penale, passjellin pavlefshmëri absolute të të gjitha akteve procedurale të marra në gjykimin në shkallë të parë. Për pasojë edhe vendimi i kësaj gjykate është i kundërligjshëm, për shkak të pavlefshmërisë absolute të akteve, dhe gjykimi në shkallë të parë konsiderohet i pakryer.

Në këto kushte, Gjykata e Apelit ka pasur detyrimin të konstatonte pavlefshmërinë e gjykimit nga gjykata e rrethit gjyqësor dhe të kthente çështjen për rigjykim në atë gjykatë. Në këtë rast, ajo nuk ka qenë kompetente për të gjykuar çështjen në themel për shkak se, në pikpamje të ligjit, nuk ka pasur fare gjykim në shkallë të parë. Në fjalë të tjera, Gjykata e Apelit nuk legjitimohej ta gjykonte vetë çështjen nga e para, qoftë edhe duke përsëritur tërësisht apo pjesërisht hetimin gjyqësor në kushtet e nenit 427 të Kodit të Procedurës Penale.

Në të tilla rrethana, kur të gjykuarit i është mohuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin se vendimi nr.246, datë 29.9.1999 i Gjykatës së Apelit të Tiranës dhe vendimi nr.172, datë 23.3.1999 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës duhet të prishen dhe aktet duhet të kthehen për rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 141 paragrafi i dytë i Kushtetutës, neni 14 pika “c” të ligjit nr.8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, në nenin 441 pika 1 germa “ç” dhe nenin 443 pika 1 të Kodit të Procedurës Penale,

V E N D O S Ë N:

1. Prishjen e vendimit nr.246, datë 29.9.1999 të Gjykatës së Apelit të Tiranës dhe vendimit nr.172, datë 23.3.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës dhe kthimin e akteve për rishqyrtim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës me tjetër trup gjykues.
2. Njësimin e praktikës gjyqësore, sipas arsytimit të mësipërm.
3. Ky vendimin për njësimin e praktikës gjyqësore të dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Duke mos qenë dakord me mënyrën e zgjidhjes së çështjes nga shumica, si dhe me arsytimin e vendimit të marrë prej saj, paraqes mendimin e pakicës si më poshtë:

Një nga të drejtat themelore të të pandehurit në procesin penal, e parashikuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në Konventën Europiane të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, është e drejta e mbrojtjes, e cila realizohet, ndër të tjera, edhe nëpërmjet të drejtës për t'u ankuar kundër vendimit të dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, si edhe garantohet prej rregullit të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit nga gjykata më e lartë, në qoftë se çështja i ka ardhur kësaj të fundit vetëm nëpërmjet ushtrimit të ankimit nga i pandehuri.

Kushtetuta dhe Konventa Europiane parashikojnë dhe garantojnë standarDin minimum të ushtrimit të një ankimi në një gjykatë më të lartë, por ato nuk kufizojnë mundësinë që ligjvënësi të parashikojë e të garantojë me ligj të drejtën për të ushtruar edhe më shumë se një ankim, duke mundësuar që çështja të kalojë për shqyrtim në të gjitha shkallët e gjykimit. Është gjithashtu e drejtë e ligjvënësit të përcaktojë me ligj kufijtë e shqyrtimit të çështjes nga gjykatat më të larta. Pavarësisht nga terminologjia e përdorur në ligj, si apeli në gjykatën e Apelit, edhe rekursi në Gjykatën e Lartë, janë mjete ankimi që i njihen të pandehurit për t'i ushtruar sipas disponibilitetit të tij dhe që i garantojnë atij pamundësinë e rëndimit të pozitës nga një gjykatë më e lartë, në qoftë se kundër vendimit nuk i ka ushtruar këto mjete ankimi edhe përfaqësuesi i akuzës (prokurori) në interes të mbrojtjes së rendit publik.

Nuk kemi ndonjë mendim të ndryshëm përsa i përket arsytimit të shumicës, duke iu referuar nenit 425 pika 2 dhe 3 të Kodit të Procedurës Penale, përsa i përket gjykimit të çështjes në gjykatën e Apelit, por mendojmë se shumica nuk i qëndron me konsekuencë arsytimit të saj përsa i përket shqyrtimit të ankimit të dytë të të pandehurit (rekursit të tij) në Gjykatën e Lartë.

I vetmi ndryshim midis gjykimit në apel dhe gjykimit në Gjykatën e Lartë, është fakti se kufijtë e shqyrtimit të çështjes në këtë të fundit janë më të ngushtë: gjykata e apelit është edhe gjykatë fakti edhe gjykatë ligji, ndërsa Gjykata e Lartë është kryesisht gjykatë që shqyrton bazueshmërinë në ligj të vendimit të kundërshtuar dhe është shumë e kufizuar përsa i takon shqyrtimit të bazueshmërisë në fakt të këtij vendimi, (vetëm, për mungesë të arsytimit ose për shkak të karakterit haptazi jologjik të tij) sipas kriterëve të vendosura në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale.

Përsa i përket parimit të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit, ai zbatohet me konsekuencë e një lloj kur janë kushtet në të dy shkallët e gjykimit si në apel, edhe në Gjykatën e Lartë. Në qoftë se prokurori, si organ përfaqësues i akuzës në emër të shtetit, e ka humbur mundësinë për ta rënduar pozitën e të pandehurit në apel, për shkak se çështja atje ka shkuar vetëm mbi bazën e ankimit (apelit) të të pandehurit, ai e ka humbur këtë mundësi përgjithmonë dhe nuk mund ta rifitojë atë më vonë nëpërmjet ushtrimit të rekursit kundër vendimit të gjykatës së apelit. Në këndvështrimin e zbatimit të parimit të mbrojtjes së të drejtave të të pandehurit në procesin penal, pjesë e të cilit është edhe e drejta e ankimit në gjykatën e apelit dhe garancia e mosrëndimit të padrejtë të pozitës së të pandehurit në këtë gjykatë (kur mungon apeli nga prokurori), për të njëjtin vendim të gjykatës së apelit nuk mund të aplikohen dy standarde vlerësimi: vendimi të konsiderohet i drejtë dhe i bazuar në ligj, sepse është dhënë konform një parimi të rëndësishëm kushtetues e ligjor, të vendosur në favor të të pandehurit dhe, njëkohësisht, të mos konsiderohet i tillë, në rast se prokurori e çon çështjen në fjalë në Gjykatën e Lartë.

Si i pandehuri, edhe prokurori, nuk mund të pengohen apo të kufizohen në të drejtën e tyre për ta çuar çështjen nga apeli në Gjykatën e Lartë dhe kjo e fundit ka të drejtë që në vendimin e saj të paraqesë e të arsyetojë të gjitha shkeljet e ligjit, për shkak të të cilave, fakteve mund t'u jetë bërë një cilësim juridik më i lehtë dhe ndaj të pandehurit, padrejtësisht, mund të jetë aplikuar një lloj apo masë dënimi më e lehtë por, si Gjykata e Lartë në gjykimin që zhvillon për shqyrtimin e rekursit të prokurorit kundër vendimit të apelit, ashtu dhe gjykatat e tjera në eventualitet të rigjykimit të çështjes në zbatim të urdhërimeve të Gjykatës së Lartë, në analizë të fundit, nuk mund të japin ndaj të pandehurit një lloj apo masë dënimi më të lartë se ai (ajo) që ka dhënë fillimisht gjykata e shkallës së parë.

Të gjitha korrigjimet e shkeljeve ligjore të mëparëshme kanë vlerë vetëm për gjykimet e tjera, me qëllim që shkelje të tilla të mos përsëriten më në të ardhmen. Në të kundërt, do të korrigjohej shkelja në çështjen konkrete, por do të dhunohej parimi kushtetues i mbrojtjes së të pandehurit në procesin penal.

Është kjo arsyeja që, në raste të tilla, balanca anon nga mbrojtja e interesit të individit në dëm të interesit publik. Këto janë kosto që rëndojnë mbi rendin publik për shkak të mangësive apo neglizhencave në sistemin e akuzës, që e bëjnë atë jo eficient, por ato janë edhe sfida e nxitje për

përmirësime e progres në një shtet të bazuar në sundimin e ligjit.

Në një vështrim më të thjeshtëzuar të problemit në fjalë, po të pranohej e kundërta, atëherë i pandehuri në çdo rast, edhe në qoftë se do ta ndjente ose do të ishte i bindur për pabazueshmërinë e vendimit të dhënë kundër tij nga gjykata e shkallës së parë, do të hezitonte të bënte ankim në apel, ose, se paku, do të priste deri në momentin e fundit të skadimit të afatit apelin e prokurorit për të vlerësuar nëse do të bënte vetë apel ose, në mungesë të apelit të prokurorit, do ta çmonte më të dobishme e më të përshtatshme që të hiqte dorë nga apeli para fillimit të gjykimit në shkallë të dytë, sesa të rrezikonte më tej.

Gjyqtar	Gjyqtar
Tefta Zaka	Thimjo Kondi

V E N D I M
Nr.85, datë 29.6.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbërë nga :

Thimjo Kondi	Kryetar i Gjykatës së Lartë
--------------	-----------------------------

Bashkim Caka	Anëtar i““““
--------------	--------------

Kristaq Ngjela	Anëtar i	“““
----------------	----------	-----

Nikoleta Kita	Anëtare e	“““
---------------	-----------	-----

Ylvi Myrtja	Anëtar i““““
-------------	--------------

Agron Lamaj	Anëtar i	“““
-------------	----------	-----

Natasha Sheshi	Anëtare e	“““
----------------	-----------	-----

Artan Hoxha	Anëtar i““““
-------------	--------------

Metush Saraçi	Anëtar i““““
---------------	--------------

Valentina Kondili	Anëtare e	“““
-------------------	-----------	-----

Vladimir Metani	Anëtar i““““
-----------------	--------------

Vladimir Bineri	Anëtar i““““
-----------------	--------------

Zamir Poda	Anëtar i““““
------------	--------------

Irma Bala	Anëtare e	“““
-----------	-----------	-----

Perikli Zaharia	Anëtar i““““
-----------------	--------------

Evgjeni Sinoimeri	Anëtare e	“““
-------------------	-----------	-----

në seancën gjyqësore të datës 29.6.2001, mori në shqyrtim çështjen nr.61 që i përket:

Paditës: KONFEDERATA E SINDIKATAVE TË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga avokat Haki Kraja

Të paditur: KOMISIONI I KTHIMIT TË PRONAVE pranë Këshillit të Rrethit Vlorë, në mungesë.

TRASHËGIMTARËT E KOSTA KOCULIT (THANAS ARJADHIMI, LIRIKA KOCULI), përfaqësuar nga av.Virgjil Karaj dhe Hanëme Bakija.

O B J E K T I:

Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Kthimit të Pronave nr.204, datë 4.11.1994

Baza ligjore: Ligji nr.7698 datë 15.4.1993 dhe udhëzimi nr.3, datë 21.6.1993

Gjykata e Rrethit të Vlorës, me vendimin nr.226, datë 5.2.1996, ka vendosur rrëzimin e padisë së palës paditëse, me objekt kundërshtim vendimi të Komisionit të Kthimit të Pronave.

Gjykata e Apelit të Tiranës, me vendimin nr.3438, datë 14.6.1996, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.226 datë 5.2.1996 të Gjykatës së Rrethit të Vlorës.

Kolegji Civil i Gjykatës së Kasacionit, me vendimin nr.639, datë 29.4.1997 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.3438, datë 14.6.1996 të Gjykatës së Apelit të Tiranës.

Kundër vendimit të Gjykatës së Kasacionit, ka bërë rekurs në interes të ligjit pala paditëse, e cila kërkon prishjen e vendimit të Gjykatës së Kasacionit e pushimin e çështjes, duke parashtruar këto shkaqe:

Për të korrigjuar disa pasoja juridike që ishin vërtetuar mbi pasurinë e sindikatave, të fituar me dekretin nr.204, datë 5.6.1992, ka dalë ligji nr. 8340/1, datë 6.5.1998 “Për rregullimin e pasojave që kanë rrjedhur nga zbatimi i dekretit nr.204 datë 5.6.1992”. Ligjvënësi i ka dhënë atij fuqi prapavepruese, gjë që del në titullin e tij. Sipas inventarit të Komisionit të Ministrisë së Financave, objekti në konflikt hyn në pasurinë e sindikatës dhe askush nuk ka të drejtë ta tjetërsojë këtë pasuri në favor të të tretëve. Çdo vendim i Komisionit të Kthimit të Pronave për kthimin e këtyre pronave ish-pronarëve bie në kundërshtim me këtë ligj.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjuan relacionin e gjyqtarëve Thimio Kondi e Evgjeni Sinoimeri dhe avokatin e palës paditëse Haki Kraja, që kërkoj prishjen e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit, atë të palës së paditur Virgjil Karaj, që kërkoj lënien në fuqi të vendimit, si dhe pasi biseduan çështjen në tërësi,

V Ë R E J N Ë:

Vendimi i Gjykatës së Kasacionit me nr.639, datë 29.4.1997, si dhe ai i Gjykatës së Apelit të Tiranës me nr.3438, datë 14.6.1996 janë marrë në përputhje me ligjin e, si të tillë, duhen lënë në fuqi.

Nga aktet e dosjes rezulton se, me dekretin nr.204 datë 5.6.1992 “Për pasurinë e sindikatave”, si dhe me akt marrëveshjen datë 28.2.1994, të përpiluar në zbatim të këtij dekreti (për pjesëtimin e pasurisë midis bashkëpronarëve BSPSH, KSSH, SP Naftës e Sporteve) palës paditëse, Konfederata e Sindikatave (dega e Vlorës) i ka kaluar pronësia mbi një objekt të emërtuar “godina nr.5 e ish-Kampit të Punëtorëve Dhërmi”. Kjo godinë deri në daljen e dekretit të mësipërm ishte pasuri në administrim të ish-Bashkimeve Profesionale.

Nga ana tjetër, trashëgimtarët e ish-pronarit Kosta Koçuli i janë drejtuar po për këtë objekt Komisionit të Kthimit të Pronave pranë Këshillit të Rrethit Vlorë dhe ky i fundit, me vendimin nr.204, datë 14.11.1994, u ka njohur dhe kthyer atyre pronësinë mbi ndërtesën njëkatëshe objekt konflikti me sipërfaqe 247 m², si dhe mbi truallin prej 667 m² me kufij të përcaktuar në vendim. Trashëgimtarët e ish-pronarit Koçuli, konform nenit 13 paragrafi 2 të ligjit nr.7698 të datës 15.4.1993 do t'i paguanin Buxhetit të Shtetit shumën prej 155.668 (njëqind e pesëdhjetë e pesëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë - shumë kjo që përfaqëson kundërvleftën e 21.97% (mbi shumën e lejuar nga ligji) të vlerës së punimeve të kryera nga shteti në këtë objekt. Kjo shumë është paguar prej ish - pronarëve. Konfederata e Sindikatave e ka kundërshtuar vendimin nr.204, datë 14.11.1994 të Komisionit të Kthimit të Pronave, me pretendimin se pronësinë e objektit në fjalë e ka fituar ajo më parë me dekretin nr.204, datë 5.6.1992.

Pala paditëse, Konfederata e Sindikatave ka kërkuar me padi anulimin e vendimit nr.204 të Komisionit të Kthimit të Pronave, duke pretenduar se ai vjen në kundërshtim me ligjin nr. 7698, datë 15.4.1993, si dhe me dekretin nr.204, datë 5.6.1992.

Gjykata e Rrethit të Vlorës, me vendimin nr.226 datë 5.2.1996, ka rrëzuar padinë e ngritur nga pala paditëse. Ky vendim i saj është lënë në fuqi dhe nga Gjykata e Apelit të Tiranës me vendimin nr. 3438, datë 14.6.1996. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbi ankimin e palës paditëse, ka vendosur, me vendimin nr. 639, datë 29.4.1997, të lërë në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit të Tiranës.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nga aktet e ndodhura në dosje, arrijnë në përfundimin se vendimet e tre gjykatave janë marrë në përputhje me ligjin.

Shkaqet e parashtruara në rekursin në interes të ligjit për prishjen e vendimeve, Konfederata e Sindikatave i mbështet kryesisht në interpretimin që i bën dekretit të Presidentit nr.204, datë 5.6.1992 “Për pasurinë e sindikatave”, si dhe ligjit nr.8340/1, datë 6.5.1998 “Për rregullimin e pasojave që rrjedhin nga zbatimi i dekretit nr.204, datë 5.6.1992 “Për pasurinë e sindikatave”.

Nisur nga sa më lart që në fillim shtrohen pyetjet:

- Cili është objekti i rregullimit juridik të dekretit në fjalë?
- Cilat janë pasojat juridike që kanë ardhur nga zbatimi i këtij dekreti?

- Në qoftë se dekreti, si akt normativ në fuqi të barabartë me ligjin, i ka prodhuar pasojat rregullisht, atëherë pse ka lindur nevoja që gjashtë vjet pas miratimit të tij, Kuvendi të nxjerrë ligjin nr.8340/1, datë 6.5.1998, i cili merret me rregullimin e pasojave që rrjedhin nga zbatimi i dekretit?

Nëpërmjet dekretit nr.204, datë 5.6.1992 Presidenti i atëhershëm i Republikës, i cili në atë kohë, ndonëse në mënyrë të kufizuar, kishte të drejtë të ushtronte edhe funksione ligjvënëse, imponoi juridikisht d.m.th. i dha fuqi detyruese një vullneti të caktuar politik, sipas të cilit pasuritë që deri atëherë ishin në administrim të sindikatave dhe që i shërbenin veprimtarisë sindikale e edukimit profesional e sindikal të punonjësve, të konsideroheshin në të ardhmen pronë të tyre.

Dekreti përcaktonte në mënyrë indikative cilat ishin pasuritë e luajtshme e të paluajtshme të sindikatave që i shërbenin qëllimit të mësipërm, si do të bëhej inventarizimi i kësaj pasurie dhe ndarja e saj midis sindikatave të ndryshme; dekreti përcaktonte gjithashtu cili do të ishte komisioni shtetëror përkatës që do të merrej me inventarizimin, vlerësimin e ndarjen e pasurisë, afatet përkatëse, si dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve eventuale.

E drejta e Presidentit për të nxjerrë një dekret normativ me fuqinë e ligjit, përse i përket pasojave që sillte, por që gjithësesi konsiderohej akt normativ nënligjor përse i përket detyrimit për t'iu nënshtruar shqyrtimit në Kuvend në sesionin më të afërt, buronte prej nenit 28 pika 19 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese". Sipas kësaj dispozite, "Presidenti i Republikës...

19...në raste të ngutshme nxjerr edhe dekrete me karakter normativ, të cilat i paraqiten për miratim Kuvendit Popullor në sesionin më të afërt".

Mirëpo, neni 29 i ligjit kushtetues nr.7491, datë 29.4.1991, në nenin 29 të tij, parashikonte se "Aktet që nxjerr Presidenti i Republikës për ushtrimin e kompetencave të parashikuara në pikat 10, 11 dhe 19 të nenit 28 të këtij ligji, marrin fuqi juridike pasi kundërfirmohen, sipas rastit, nga Kryetari i Këshillit të Ministrave ose nga ministri përkatës apo nga personat e tjerë të njëzuar me to".

Ka rezultuar se dekreti i Presidentit nr.204, datë 5.6.1992 "Për pasurinë e sindikatave jo vetëm nuk i është paraqitur për miratim Kuvendit në sesionin më të afërt, por edhe nuk është kundërfirmuar nga Kryeministri apo nga Ministri i Financave. Për rrjedhojë, ky dekret nuk konsiderohet se ka marrë fuqi juridike. Megjithatë, ky dekret pa fuqi juridike është zbatuar dhe, në zbatim të tij, është bërë kalimi i pasurisë në pronësi të sindikatave të ndryshme.

Nga sa më lart konkludohet se aktet me të cilat është bërë kalimi i pasurisë në pronësi të sindikatave janë të paligjësime e, si të tilla, absolutisht të pavlefshme (nul). Kjo do të thotë se këto akte (marrëveshjet midis sindikatave për ndarjen e pasurisë dhe çdo akt tjetër që lidhet me to, e që përbën disponim të pasurisë) konsideroheshin ligjërish të paqena.

Kjo gjendje paligjshmërie është marrë në shqyrtim nga Kuvendi i Shqipërisë i një legjislature pasardhëse, i cili, duke konstatuar se dekreti nuk ishte kundërfirmuar dhe, si i tillë, nuk kish marrë fuqi juridike, me ligjin nr.8340, datë 6.5.1998, vendosi të mos ta miratojë atë.

Ndërkohë Kuvendi miratoi ligjin nr.8340/1, datë 6.5.1998 "Për rregullimin e pasojave rrjedhur nga zbatimi i dekretit nr.204, datë 5.6.1992 "Për pasurinë e sindikatave".

Pala paditëse, me pretendimin që ky ligj është një ligj me karakter prapaveprues, gjë që, sipas saj, rezulton nga vetë titulli i tij, ka kërkuar që të konsiderohen të mirëqena të gjitha pasojat që ka sjellë dekreti i paligjshëm nr.204, datë 5.6.1992 dhe, për rrjedhojë, të shuhet të gjitha pasojat që kanë sjellë ligje të tjera të nxjerra rregullisht pas tij, për ato pjesë që bien në kundërshtim me dekretin në fjalë dhe me ligjin nr. 8340/1, datë 6.5.1998, që ka rregulluar në mënyrë prapavepruese pasojat e tij. Në këtë kuadër përfshihet edhe ligji nr. 7698, datë 15.4.1993, "Për kthimin e kompensimin e pronave ish-pronarëve", për pjesën që disponon në favor të ish-pronarëve ndërtesa të pandryshuara apo troje të pazëna, ish-pronë e tyre, të shtetëzuara, konfiskuara, shpronësuar etj. Nga shteti, pas datës 29.11.1994, sepse sipas saj (palës paditëse) këto pasuri nuk mund t'u merren më sindikatave përkatëse. Kjo do të thotë që të shfuqizohen të gjitha vendimet e Komisioneve të Kthimit të Pronave e të gjitha vendimet gjyqësore që, për pronat e mësipërme, kanë disponuar me favor të ish-pronarëve apo trashëgimtarëve të tyre.

Mirëpo Komisionet e Kthimit të Pronave dhe gjykatat, kur kanë shqyrtuar çështjet kanë zbatuar ligjin e kohës që ishte në fuqi, d.m.th. ligjin nr. 7698, datë 15.4.1993

Ato nuk mund të zbatonin një dekret presidencial, që, sipas dispozitave kushtetuese, nuk kishte marrë fuqi juridike. Nga ana tjetër, një ligj i miratuar disa vjet më vonë, siç është ligji nr. 8340/1, datë 6.5.1998, edhe sikur të konsiderohet si ligj me fuqi prapavepruese, nuk mund të shuajë

pasojat që kanë ardhur si rezultat i zbatimit të ligjeve të kohës. Si organet e pushtetit ekzekutiv e të administratës shtetërore, edhe gjykatat kanë pasur të drejtë e kanë qenë të detyruara të zbatojnë vetëm ligjet (normat juridike) që kanë qenë në fuqi në kohën kur kanë shqyrtuar e kanë vendosur për çështjet konkrete përkatëse.

Gjersa pasojat për çështjet konkrete kanë ardhur nën regjimin e një ligji të mëparshëm, siç është ligji për kthimin e pronave, atëherë këto çështje, qoftë edhe me karakter prapaveprues, konsiderohen të përfunduara dhe rregullimet e ndryshme të mëvonshme nuk mund t'i prekin ato.

Gjithësesi, një ligji i ri, me karakter prapaveprues ose jo, ose duhet të rregullojë disa marrëdhënie që nuk ishin rregulluar më parë juridikisht, ose duhet t'u bëjë një rregullim të ndryshëm marrëdhënieve të mëparshme d.m.th. të shfuqizojë apo ndryshojë, të paktën, një ose disa norma të mëparshme.

Po t'i referohemi ligjit nr. 8340/1, datë 6.5.1998 "Për rregullimin e pasojave, që kanë rrjedhur nga zbatimi i dekretit nr. 204, datë 5.6.1992 "Për pasurinë e sindikatave", kontatojmë se:

1.Nuk gjejmë asnjë dispozitë që të shfuqizojë, jo më në mënyrë të shprehur, por edhe të nënkuptuar, ndonjë dispozitë të mëparshme.

2.Disa dispozita të këtij ligji janë thjesht përsëritje të disa dispozitave të dekretit nr. 204, datë 5.6.1992 (p.sh. nenet 1, 2).

3.Disa dispozita të tjera përmbajnë rregullime që bëhen për herë të parë përsa i përket mënyrës së administrimit nga ana e sindikatave të pasurisë së përfutur nga shteti, si dhe vendosin disa kufizime në ushtrimin e plotë të tagrave të sindikatave si pronare të pasurisë së përfutur nga shteti, (nenet 4, 6, 8). Gjithsesi, këto dispozita të reja nuk prekin problemin themelor që lidhet me çështjen objekt shqyrtimi: nëse pasuria që ka qenë e ish-pronarëve dhe që shteti ua ka kaluar sindikatave, do të vazhdojë t'u lihet në të ardhmen në pronësi atyre apo do t'u kthehet ish-pronarëve (trashëgimtarëve të tyre) sipas kriterëve të vendosur me ligjin nr. 7698, datë 15.4.1993?

4.Në këtë ligj hasim edhe një dispozite me karakter thjesht referues, siç është ajo e parashikuar në nenin 5 të tij. Sipas kësaj dispozite, "Trualli pasuri e sindikatave, sipas nenit 1 të këtij ligji, konsiderohet pronë e zënë. Ish-pronarët kompensohen sipas ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin e kompensimin e pronave ish-pronarëve".

Në funksion të problemit të shtruar për zgjidhje në çështjen objekt shqyrtimi në Kolegjet e Bashkuara, d.m.th. nëse prona e ish-pronarëve në formën e ndërtesave ekzistuese apo trojeve të pazëna që u ka kaluar sindikatave në vitin 1992, do të vazhdojë të mbetet në pronësi të sindikatave apo do t'u kthehet ish-pronarëve (trashëgimtarëve të tyre) sipas kriterëve të ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993, duhet të përqendrohemi vetëm në ballafaqimin midis dy regjimeve juridike: atij të bërë me ligjin nr. 8340/1, datë 6.5.1998 dhe atij të bërë me ligjin nr. 7698, datë 15.4.1993.

Më konkretisht, pyetja shtrohet si më poshtë:

Në rastet e ndeshjes (kolizionit) midis dy regjimeve të ndryshme juridike, të pasqyruara në dy ligje të ndryshme, dispozitat e cilit ligji do të zbatohen?

Në analizë të fundit, në zgjidhjen e çështjes objekt shqyrtimi, e të çështjeve të ngjashme si kjo, do të kenë përparësi interesat e ish-pronarëve (trashëgimtarëve të tyre) apo interesat e sindikatave?

Për efekt të unifikimit të praktikës gjyqësore për këtë problem, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nëpërmjet këtij vendimi konkludojnë se:

1. Sa herë që përplasen interesat e ish-pronarëve (trashëgimtarëve të tyre) që përfitojnë kthimin (restitucionin) e ndërtesave të pandryshuara apo trojeve të pazëna, sipas dispozitave të ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993, me interesat e sindikatave, që i kanë fituar këto ndërtesa apo troje, sipas dekretit nr. 204, datë 5.6.1992, pasojat e të cilit janë rregulluar me ligjin nr. 8340/1, datë 6.5.1998, përparësi ka mbrojtja e interesave të ish-pronarëve (trashëgimtarëve të tyre).

2.Ligji nr. 8340/1, datë 6.5.1998 "Për rregullimin e pasojave që kanë rrjedhur nga zbatimi i i dekretit nr. 204, datë 5.6.1992 "Për pasurinë e sindikatave" është i zbatueshëm për atë që nuk bie në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve".

Edhe sikur dekreti nr. 204, datë 5.6.1992 "Për pasurinë e sindikatave" të kish marrë fuqi juridike rregullisht, duke u kundërfirmuar nga Kryeministri e nga Ministri i Financave, si dhe të ish miratuar nga Kuvendi rregullisht në sesionin më të afërt, përsëri përparësi do të kish ligji për kthimin e kompensimin e pronave ish-pronarëve kundrejt dekretit mbi pasurinë e sindikatave.

Në pamje të parë krijohet idea që përparësi duhet të kishte dekreti, sepse ky akt normativ me

fuqinë e ligjit është miratuar përpara ligjit dhe se njohja e të drejtës së pronësisë së sindikatave mbi pronat që kanë në administrim në funksion të qëllimit të ushtrimit të veprimtarisë së tyre, sipas ligjit e statutit të tyre, do të përbënte një rregullim të veçantë në raport me rregullimet e përgjithshme të marrëdhënieve të pronësisë që bëhet me ligjin për kthimin e kompensimin e pronave ish-pronarëve. Është parim juridik i njohur dhe i gjithëpranuar ai sipas të cilit përparësi në respektim merr rregullimi i veçantë i pranuar në një ligj të caktuar kundrejt rregullimit të përgjithshëm, të pranuar në një ligj tjetër, në qoftë se njëri ligj nuk konsiderohet se shfuqizon tjetrin.

Megjithatë, dy regjimet juridike të dy akteve normative me fuqinë e ligjit (dekretit dhe ligjit në fjalë) në një vështrim më të përgjithshëm, do të përbënin një kuadër të caktuar të një regjimi juridik në ndryshim, i cili ka pasqyruar e ka rregulluar në një proces evoluimi të shpejtë idetë dhe qëllimet e ligjvënësimit me karakter politik, ekonomik e social.

Në atë kohë nuk kishte filluar ende ndonjë nismë ligjvënëse për kthimin e pronave apo kompensimin e ish-pronarëve të shpronësuar nga shteti në periudhën e regjimit komunist dhe ligjvënësi (përfshi edhe Presidenti) nuk kishin ndonjë pengesë juridike për të disponuar pjesë të pronës shtetërore në dobi të sindikatave, të cilat, pas ndryshimeve përkatëse ligjore, fitonin një personalitet të plotë juridik, pjesë e të cilit do të ishte edhe pavarësia e tyre e plotë ekonomike e financiare. Në atë kohë nuk përjashtohej mundësia që sindikatave t'u kalonin në pronësi, sipas modaliteteve të dekretit, edhe ndërtesa të pandryshuara apo troje të lira, të cilat ishin shtetëzuar, shpronësuar, konfiskuar apo marrë pa të drejtë nga shteti me çdo mënyrë tjetër, pas datës 29 nëntor 1944.

Me hyrjen e tij në fuqi, ligji nr. 7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin e kompensimin e pronave ish-pronarëve” solli një rregullim të plotë e të drejtë të problemit të kthimit të pronave apo kompensimit të ish-pronarëve.

Ligjvënësi vendosi të kthejë në natyrë e jo të kompensojë, të gjitha ndërtesat e pandryshuara e trojet e lira (të pazëna), të ish-pronarëve, pa bërë përjashtim në se këto vazhdonin të ishin në pronësi të shtetit apo kishin kaluar gjatë viteve të shkuara në pronësi të pronarëve të tjerë. Ky rregull zbatohet pa përjashtim edhe kundër atyre që i kishin përfituar këto prona kundrejt shpërblimit e me mirëbesim dhe i kishin poseduar e gëzuar ato qetësisht për një kohë të gjatë.

Në këtë drejtim ligjvënësi nuk ka bërë përjashtim për asnjë person të tretë përfitues të ligjshëm, përfshi këtu edhe sindikatat përfituese prej dekretit në fjalë, në eventualitet që dekreti të kish fituar fuqi juridike rregullisht. Sipas këtij ligji, personat e tretë përfitues të ligjshëm nuk do të prekeshin vetëm në qoftë se ish-pronar i pronës së kërkuar për t'u kthyer do të ishte ndonjë nga subjektet e parashikuara në nenet 23 e 24 të tij.

Si përfundim, dekreti nr. 204, datë 5.6.1992 do të ruante fuqinë, po ta kish fituar atë rregullisht, dhe ligji nr. 8340/1, datë 6.5.1998 do të ishte i zbatueshëm përse i përket pronave në formën e ndërtesave të pandryshuara apo trojeve të pazëna, duke i lënë ato në pronësi të sindikatave, vetëm në eventualitet të ekzistencës së kushteve të neneve 23 e 24 të ligjit të kthimit të pronave, si dhe në mënyrë evidente, në rastet kur ish-pronarët (trashëgimtarët e tyre) rezulton të mos u jenë drejtuar Komisioneve të Kthimit e Kompensimit të Pronave të ngritura pranë Bashkive e Këshillave të rretheve. Kuptohet që këtu nuk vihet në diskutim fitimi nga sindikatat i pronësisë mbi pasurinë shtetërore që shteti ka vendosur t'ua kalojë sindikatave dhe që nuk ka lidhje me atë pasuri të paluajtshme që u kthehet ish-pronarëve apo trashëgimtarëve të tyre.

Gjithashtu nënvizojmë se, ligji nr. 7698 datë 15.4.1993, në nenin 29 të tij, parashikon se, “Të gjitha dispozitat ligjore që vijnë në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen”.

Në këtë drejtim nuk do të bënte përjashtim edhe dekreti nr. 204, datë 5.6.1992 edhe sikur ai të kish marrë fuqi juridike pas nxjerrjes së tij, nëpërmjet kundërfitimit të tij, sipas nenit 29 të ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”. Ai do të gjente zbatim vetëm brenda hapësirës që nuk do të krijonte ndeshje me ligjin e kthimit e të kompensimit të pronave. Brenda kësaj hapësire do të gjejë zbatim gjithashtu edhe ligji nr. 8340/1, datë 6.5.1998, i cili marrë ka përsipër të rregullojë pasojat që kanë rrjedhur nga zbatimi i dekretit...” Edhe “rregullimi i pasojave” për të ardhmen nuk mund të bëhet në një mënyrë të tillë që t'u bjerë ndesh dispozitave të ligjit të kthimit e kompensimit të pronave ish-pronarëve.

Në të gjitha rastet, kur ka konflikt midis ish-pronarëve e sindikatave përparësi në zgjidhjen e tyre merr interpretimi e zbatimi i ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993. Kjo përparësi respektohet jo vetëm kur këto konflikte kanë lindur, janë gjykuar dhe vendimet kanë marrë formë të prerë para hyrjes në fuqi të ligjit 8340/1, datë 6.5.1998, por edhe për rastet e vërtetuara pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 485/a të Kodi i Procedurës Civile,

V E N D O S Ë N:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 3438, datë 19.6. të Gjykatës së Apelit të Tiranës dhe nr. 639, datë 29.4.1997 të Gjykatës së Kasacionit.
2. Ky vendim unifikues për praktikën gjyqësore të dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

V E N D I M
Nr. 78, datë 16.7.2001

" N Ë E M Ë R T Ë R E P U B L I K Ë S S Ë S H Q I P Ë R I S Ë "

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci,	Anëtar i ""
Gjergj Sauli,	Anëtar i ""
Alfred Karamuço,	Anëtar i ""
Kujtim Puto,	Anëtar i ""
Kristofor Peçi,	Anëtar i ""
Petrit Plloçi,	Anëtar i ""
Tefta Zaka,	Anëtare e ""
Sokol Sadushi,	Anëtar i ""

me sekretare Drita Panda, në datën 9.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.84 Akti që i përket:

KËRKUES: Nikollë Lesi, kandidat për deputet i pavarur, përfaqësuar me prokurë nga avokat Përparim Sanxhaku.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KOMISIONI QENDROR i ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj, me autorizim.
2. LLESH KOLA, kandidat për deputet i pavarur, përfaqësuar me deklaram nga avokat Baftjar Rusi.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr. 012, datë 1.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr. 13 Lezhë

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e vendimit:

- Në kundërshtim me nenet 94/2 dhe 106/B të ligjit nr. 8609, datë 5.8.2001, nuk janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe mbylljen e qendrave të votimit.

- Në qendrat e votimit nr. 7 e 8 të Komunës Kolsh dhe nr. 8 të Komunës Zejmen nuk u gjendën tabelat origjinale dhe as kopje të modeleve 54, 55 e 56, ndërsa mungesa të pjesshme janë vërejtur edhe në qendra të tjera votimi.

- Në mjaft raste, tabelat e rezultateve 54, 55, 56 janë pa firmë e vulë, veprim ky në kundërshtim me nenin 106/5 të Kodit Zgjedhor.

- Ka mospërputhje në shifra sipas rezultateve që pasqyrohen në tabelat e rezultateve, si në qendrën e votimit nr. 1 Kolsh, nga ku dalin 138 fletëvotimi më tepër nga sa janë tërhequr.

Mospërputhje shifrash vërehen edhe në tabela të qendrave të tjera të votimit.

- Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është i paligjshëm sepse nuk i ka dhënë përgjigje pretendimeve të anëtarëve të Komisionit të Zonës Zgjedhore, të cilët kanë bërë vërejtje për çrregullime e pasaktësi të rezultatit e të procesit zgjedhor. Në disa raste, shumica e anëtarëve të Komisionit të Zonës Zgjedhore ka kundërshtuar rezultatit e megjithatë, ky mendim shumice është trajtuar si observacion. Komisioni i Zonës Zgjedhore, këto kundërshtime, ia ka lënë për t'i rishqyrtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, por nga ky komision nuk janë vlerësuar seriozisht.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kryetarin Fehmi Abdiu, përfaqësuesin e kërkuarit, të subjekteve të interesuara, u njoh me përmbajtjen e dokumenteve, si dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Në Zonën Zgjedhore nr. 13 Lezhë përfshihen Komunitetet Zejmen, Kolsh dhe Shënkoll, si dhe Bashkia e Lezhës, me gjithsej 43 qendra votimi. Sipas dokumenteve, në Zonën Zgjedhore nr. 13 kanë kandiduar 12 kandidatë për deputetë midis të cilëve edhe kërkuari Nikollë Lesi.

Komisioni i Zonës Zgjedhore nr. 13, pas përfundimit të raundit të parë të zgjedhjeve të 24 qershorit 2001, me vendimin nr. 14, datë 26.6.2001 ka vendosur të shpallë deputet të drejtëpërdrejtë në këtë zonë zotin Llesh Zef Kola.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi ka shqyrtuar procesverbalet dhe tabelat e sjella nga Komisioni i Zonës Zgjedhore nr. 13, me vendimin nr. 012, datë 1.7.2001, me shumicë votash ka vendosur: "Të shpallë rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve në Zonën Zgjedhore nr. 13, duke njohur si fitues kandidatin për deputet zotin Llesh Kola, të pavarur".

Pas verifikimit të pretendimeve të kërkuarit me dokumentet e sjella si provë prej tij, duke i krahasuar ato me dokumentet e sjella nga përfaqësuesi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe subjekti i interesuar zoti Llesh Kola, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se procesi zgjedhor në zonën nr. 13 është karakterizuar nga parregullsi dhe shkelje serioze të ligjit. Parregullsitë dhe shkeljet e ligjit janë vërejtur në radhë të parë në veprimtarinë e shumë komisioneve të qendrave të votimit, të cilat kanë reflektuar më pas edhe në veprimtarinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Natyra e shkeljeve të ligjit dhe parregullsive të vërtetuara, si dhe shtrirja e tyre, në vështrim të nenit 113 shkronja "a" të Kodit Zgjedhor, i bëjnë zgjedhjet të pavlefshme në tërë zonën zgjedhore nr. 13 Lezhë.

Sipas tabelave të përpiluara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nr. 13 Lezhë dhe të paraqitura si provë nga përfaqësuesi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, rezultojnë se anëtarët e Komisionit të Zonës Zgjedhore kanë pasur vërejtje dhe kundërshtime për parregullsi të dokumenteve dhe për shkelje të ligjit nga komisionet e qendrave të votimit. Kështu, me rastin e marrjes në dorëzim të dokumenteve të qendrave të votimit nga Komisioni i Zonës Zgjedhore, rezultojnë se në kutitë e votimit të 15 qendrave të votimit nuk janë gjendur plotësisht ose pjesërisht tabelat e rezultateve. Në kutitë e qendrave të votimit nr. 7 Kolsh dhe nr. 8 Zejmen nuk janë gjendur asnjë nga tabelat model 54,55,56, ndërsa në mjaft raste të tjera si në qendrën e votimit nr. 5/1 Lezhë, në qendrat e votimit nr.2 dhe 9 Kolsh, në qendrën e votimit nr. 8 Shënkoll, etj., mungonin nga dy tabela të rezultateve, veprime këto që janë në kundërshtim me pikën 8 të nenit 106 të Kodit Zgjedhor.

Po kështu, në 10 qendra votimi, në kundërshtim me nenin 94 dhe 106 pika 9 të Kodit Zgjedhor nuk janë gjendur procesverbalet e hapjes dhe të mbylljes së qendrës së votimit, si në atë me nr.8 Zejmen, nr. 3/1 Lezhë, nr. 10 Kolsh, etj.

Parregullsi jo të pakta janë vërejtur për moskorrespondimin e vulave apo të mungesës së vulave origjinale. Kështu, në qendrën e votimit nr. 9 Kolsh, kutitë e votimit u mbyllën dhe u vulosën nga Komisioni i Zonës Zgjedhore me plastelinë, sepse mungonin vulat origjinale. Në qendrën e votimit nr. 3 Shënkoll dhe nr. 10 Lezhë, vulat nuk janë të njëjta me ato të procesverbalit të mbylljes së qendrës së votimit.

Disa tabela rezultatesh të qendrave të votimit nuk janë vulosur apo nënshkruar nga komisioni, si në qendrën e votimit nr. 5 Shënkoll, që tabela 55 u gjet pa vulë e pa firmë të kryetarit, tabela 55 në qendrën e votimit nr.3 Lezhë u gjet e paplotësuar por e nënshkruar nga komisionerët, tabelat 54, 55, 56 në qendrën e votimit nr. 6 Zejmen të panënshkruara nga komisioni.

Pikërisht këto shkelje të kërkesave të nenit 106 të Kodit Zgjedhor, të shoqëruara me mospërputhje të shifrave në disa tabela, sidomos të qendrave të votimit të Komunës Kolsh, i kanë detyruar anëtarët e Komisionit të Zonës Zgjedhore të paraqesin kundërshtimet e tyre, që kanë gjetur pasqyrim në Tabelat Përmbledhëse të Komisionit të Zonës Zgjedhore dhe ky Komision, ndonëse i ka konsideruar të drejta, ka nxjerrë rezultatet dhe ka shpallur fituesin mbi bazën e të dhënave të pasakta e të paplota të dërguara nga komisionet e qendrave të votimit. Më konkretisht: Tabela Përmbledhëse e Rezultateve të Zonës Zgjedhore nr. 13 model 39/1 është kundërshtuar nga komisionerët e Komisionit të Zonës Zgjedhore, Fatmir Delishi, Ded Rramani, Gëzim Muçiku dhe Ndue Bici dhe Komisioni i Zonës Zgjedhore ka vendosur: "Të marrë në konsideratë parregullsitë e konstatuara në të gjitha tabelat e kandidatit dhe materialet e të gjitha qendrave të votimit të zonës zgjedhore nr. 13 t'i kalojnë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për rishqyrtimin e çdo parregullsie". Po kështu, katër anëtarët e Komisionit të Zonës Zgjedhore kanë bërë vërejtje dhe kundërshtime për tabelën e rezultateve të qendrave të votimit nr. 10, 5, 3, 9 dhe 4 të Komunës Shënkoll për shkak të mospërputhjes së shifrave dhe të mungesës së tabelave të rezultateve, të cilat gjithashtu janë konsideruar të drejta nga Komisioni i Zonës Zgjedhore. Kundërshtime ka pasur edhe për tabelat e rezultateve të Komunave Kolsh, Zejmen dhe Bashkia Lezhë, pra pothuajse për të gjitha qendrat e votimit të zonës zgjedhore nr. 13 Lezhë. I ndodhur para një situatë të tillë, ku në disa raste kundërshtimet kanë qenë edhe nga shumica e anëtarëve të Komisionit të Zonës Zgjedhore, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhej të tregojë ekzigjencën për vlerësimin e shkeljeve të ligjit dhe të parregullsive të tjera të vërejtura në zonën zgjedhore nr. 13, lidhur me vlefshmërinë e zgjedhjeve në këtë zonë dhe në vështirësi të nenit të Kodit Zgjedhor, të mbante një qëndrim të ndryshëm nga ai ka mbajtur.

Për mungesë serioziteti nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, megjithëse nuk ka rëndësi për kandidatët, dëshmon edhe pranimi si i saktë nga ky Komision të Tabelës 40/1 të rezultateve përmbledhëse për deputetët të listës shumëemërore, në të cilën ka pasaktësi të dukshme të shifrave të pasqyruara në të. Në këtë tabelë figurojnë 28 999 fletëvotimi të marra në dorëzim, shifër kjo që nuk përputhet me të dhënat e kolonave 5,6 e 7, duke krijuar një diferencë prej 4 283 fletëvotimi. Në kolonën 7 pasqyrohet se u gjetën në kuti 11 847 fletëvotimi, nga këto të pavlefshme 472 dhe të vlefshme 13 458, pra 1 611 më shumë se sa numri i fletëvotimeve të gjetura në kuti, ndërsa në faqen e brendshme të tabelës, vota të vlefshme janë shënuar 14 374, shifër kjo që nuk përputhet me asnjë shifër të faqes së parë.

Gjithashtu vlen të theksohet se në qendrën e votimit nr. 13 të Bashkisë Lezhë (Komisariat), votimet nuk rezultojnë të jenë zhvilluar, gjë që kuptohet nga tabela e rezultateve model 39 të kësaj Bashkie, duke iu mohuar kështu 48 personave të regjistruar në listë e drejta kushtetuese për të votuar.

Veç sa sipër, kërkuesi paraqiti në seancë gjyqësore disa akte të ekspertimit grafik të tabelave të rezultateve të qendrave të votimit të Komunës Shënkoll, sipas të cilave konkludohet për falsifikime të nënshkrimeve të anëtarëve të komisionit. Kështu, sipas aktit të ekspertimit për komisionerët e qendres së votimit nr. 4, të katër nënshkrimet përbri emrit dhe mbiemrit janë shkruar nga e njëjta dorë. E njëjta gjë thuhet edhe për nënshkrimet e Shtjefën Dodës, Fran Lucës, Gjeto Lucës etj., të ndodhura në modelarët 54 dhe 55, nuk janë nënshkruar nga e njëjta dorë. Në qendrën e votimit nr. 13 janë ekspertuar nënshkrimet e gjashtë anëtarëve të komisionit të ndodhura në katër tabela rezultatesh dhe që të gjitha nënshkrimet nuk janë shkruar nga e njëjta dorë.

Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nuk është ankimuar nga ndonjë subjekt politik përse i përket rezultateve në listën shumëemërore, kështu që Gjykata Kushtetuese, bazuar në nenin 48 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" i përmbahet objektit të kërkesës të paraqitur nga kandidati i pavarur zoti Nikollë Lesi për përsëritjen e zgjedhjeve për listën njëemërore, kërkesë kjo që e parë në kompleksitet me shkeljet, si dhe me pretendimet e tjera të ngritura për falsifikime dhe shtesa në tabelat apo në listat e zgjedhësve, duhet pranuar, duke urdhëruar përsëritjen e zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr. 13 Lezhë për listën njëemërore.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/e të Kushtetutës, nenit 113 të Kodit Zgjedhor, si dhe neneve 26 e 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin e vendimit nr. 012, datë 1.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për shpalljen e rezultateve përfundimtare të votimit në zonën zgjedhore nr. 13 Lezhë për shkak të konstatimit të parregullsive serioze gjatë procesit zgjedhor zonal.

- Urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr. 13 vetëm për listën njëemërore.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M Nr.79, datë 18.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i “““
Gjergj Sauli	Anëtar i “““
Alfred Karamuço	Anëtar i “““
Kristofor Peçi	Anëtar i “““
Kujtim Puto	Anëtar i “““
Petrit Plloçi	Anëtar i “““
Tefta Zaka	Anëtare e “““
Sokol Sadushi	Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 16.7.2001. mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.97 Aktin që i përket:

Kërkues: Pëllumb Vladi, kandidat për deputet i Partisë Socialiste, përfaqësuar nga avokat Arben Hakani.

Subjekte të interesuarA:

1. Komisioni Qendror i zgjedhjeve, përfaqësuar nga Sokol Lamaj
2. Ibrahim Bruka

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.158, datë 10.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kërkuesi për shfuqizimin e vendimit nr. 158, datë 10.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka parashtruar këto shkaqe:

- Vulat e disa qendrave të votimit në Bërshullë dhe Paskuqan janë dorëzuar në Komisionin e Zonës Zgjedhore jashtë kutisë, ndërsa një kuti votimi ka qenë e hapur.

- Në tre qendra votimi në Paskuqan dhe Bërshullë janë zhdukur 964 fletë votimi.

- Në tre qendra votimi janë lejuar të nënshkruajnë procesverbalet komisionerë të jashtëligjshëm.

- Në disa qendra votimi në Zall-Herr dhe Paskuqan janë penguar të votojnë mbi 600 ushtarë dhe rreth 800 zgjedhës.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesin e kërkuesit, subjektet e interesuara dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N :

Komisioni i Zonës Zgjedhore nr.44, me vendimin nr.6, datë 9.7.2001, ka shpallur deputet të drejtpërdrejtë në këtë zonë Brahim Bruka. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.158, datë 10.7.2001, ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në zonën nr.44, duke e njohur këtë kandidat si fitues.

Të gjitha shkeljet që pretendohen nga kërkuesi i referohen raundit të dytë të zgjedhjeve të zhvilluar më datën 8.7.2001. Sipas tabelës së rezultateve të këtij raundi zgjedhjesh, të pasqyruar në modelin 39/1, rezulton se kërkuesi ka marrë 4 537 vota kundrejt fituesit që ka marrë 6 064 vota.

Nga provat e administruara të cilat ndodhen në dosjen gjyqësore, Gjykata Kushtetuese çmon se shkeljet e konstatuara nuk janë të tilla që të ndikojnë në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në këtë zonë. Një pjesë e pretendimeve për shkelje të parashtruara nga kërkuesi nuk u provuan, pasi sipas ligjit, edhe barra e të provuarit i përket atij që e pretendon. U pretendua se kutia e votimit e qendrës nr.2 Bërxullë ka ardhur në Komisionin e Zonës Zgjedhore e hapur, ndërsa në disa qendra të tjera, vulat e njoma kanë qenë jashtë kutive të votimit. Këto pretendime jo vetëm që nuk u provuan përpara gjykatës me prova, por edhe nëse do të ekzistonin si shkelje, përderisa kërkuesi nuk i konteston si të pavërteta rezultatet e pasqyruara në procesverbalet e këtyre qendrave të votimit, një kopje të të cilave ai e ka administruar, atëherë ato mbeten të papranueshme.

Edhe lidhur me pretendimin për zhdukjen e 940 fletëvotimeve në qendrën e votimit nr.12 të Komunës së Paskuqanit, të cilat nuk rakordojnë me të dhënat e procesverbalit, kërkuesi duhej të provonte përpara gjykatës se këto fletëvotime janë përdorur në disfavor të tij në ndonjë qendër tjetër votimi brenda kësaj zone zgjedhore, duke ndikuar padrejtësisht në rezultat. Përfaqësuesi i zotit Brahim Bruka, lidhur me këtë pretendim të kërkuesit, paraqiti në seancë gjyqësore procesverbalin e kësaj qendre votimi në të cilën nuk rezulton një mangësi e tillë në fletët e marra në dorëzim, por vihet re mosplotësim në disa ekstremite të procesverbalit, që ka sjellë mosevidentimin e saktë të sasive të fletëvotimeve.

Lidhur me nënshkrimin në procesverbalet e tre qendrave të votimit të tre personave të cilët nuk ishin emëruar si anëtar komisioni, Gjykata Kushtetuese konkludon se, pavarësisht se ata kanë qenë me cilësinë e përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore përkatëse, nënshkrimi i tyre si komisionerë përbën shkelje të ligjit. Megjithatë duke vlerësuar se kjo shkelje ligjore, në kuptim dhe të nenit 113 pika 1 shkronja “a” të Kodit Zgjedhor, nuk është e një natyre të tillë që të ndikojë drejtpërdrejt në rezultatin e ndjeshëm midis dy kandidatëve, ajo mbetet për t’u evidentuar si parregullsi, e cila nuk e bën cenueshëm vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Pretendimi tjetër i kërkuesit për mohimin e të drejtës për të votuar të rreth 800 zgjedhësve, si dhe pengimin e 600 ushtarëve për të votuar me librezë ushtarake nuk u shoqërua me asnjë provë për t’i krijuar bindje gjykatës për vërtetësinë e parregullsive të tilla.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkesa nuk gjen mbështetje në prova dhe në ligj dhe për rrjedhojë duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 shkronja “e” dhe 132 të Kushtetutës, në nenet 26 dhe 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 113 të Kodit Zgjedhor, njëzëri,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M
Nr.87, datë 11.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergj Sauli	Anëtar i “““
Zija Vuci	Anëtar i “““
Alfred Karamuço	Anëtar i “““
Kujtim Puto	Anëtar i “““
Kristofor Peçi	Anëtar i “““
Petrit Plloçi	Anëtar i “““
Sokol Sadushi	Anëtar i “““
Tefta Zaka	Anëtare e “““

me sekretare Arbenka Lalice, në datën 11.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.87 Akti që i përket:

Kërkuese: Esmeralda Uruçi, candidate për deputete e Partisë Socialiste, përfaqësuar me prokurë nga avokat Përparim Sanxhaku.

Subjekte të Interesuara:

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj.
2. Astrit Bushati, përfaqësuar me deklaram nga avokat Bujar Hoti.
3. Komisioni i Zonës Zgjedhore, përfaqësuar nga zëvendëskryetari Sulejman Sulaj.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.956, datë 29.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe deklarimi i pavlefshëm i zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.5 Shkodër

Kërkuesja, për shfuqizimin e vendimit të sipërm, ka parashtruar këto shkaqe:

- Në Komisionet e Qendrave të Votimit nr.44 dhe 53 nuk korrespondojnë shifrat e tabelës përmbledhëse në formularin model 56.
- Në Komisionet e Qendrave të Votimit nr.46 dhe 46/1 mungon vula e Komisionit të Qendrës së Votimit në formularin model 56, faqe 1.
- Në Komisionet e Qendrave të Votimit nr.57 e 58 procesverbali është dorëzuar me korrigjime.
- Në Komisionet e Qendrave të Votimit nr.63 e 64 nuk kanë nënshkruar anëtarët e komisionit, por vetëm kryetari dhe zëvendëskryetari.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Tefta Zaka, përfaqësuesin e kërkuesses, subjektet e interesuara dhe analizoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.956, datë 29.6.2001, ka shpallur rezultatin e zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.5, duke njohur si fitues kandidatin e pavarur për deputet zotin Astrit Bushati, i mbështetur nga PD+BF.

Kërkuesja Esmeralda Uruçi ka kërkuar shfuqizimin e vendimit të sipërm dhe shpalljen të palvefshme të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.5 me pretendimin se janë bërë shumë shkelje si gjatë procesit zgjedhor, edhe në nxjerrjen e rezultatit.

Gjatë gjyqimit rezultoi se kërkuessa nuk ka bërë ankim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

ndaj vendimit nr.10, datë 26.6.2001 të Komisionit të Zonës Zgjedhore nr.5, konform nenit 140/2 të Kodit Zgjedhor.

Në kuptim të nenit 131 shkronja “f” të Kushtetutës, kërkesja nuk ka konsumuar mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave të saj, sepse nuk ka ushtruar ankimin në rrugën administrative.

Në këto kushte, kërkesja nuk legjitimohet t’i drejtohet me kërkesë Gjykatës Kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131 shkronja “e” dhe “f” të Kushtetutës, nenit 140 të Kodit Zgjedhor, si dhe neneve 26 e 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës,
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M

Nr.93, datë 23.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergj Sauli	Anëtar i “““
Alfred Karamuço	Anëtar i “““
Kristofor Peçi	Anëtar i “““
Kujtim Puto	Anëtar i “““
Petrit Plloçi	Anëtar i “““
Tefta Zaka	Anëtare e “““
Sokol Sadushi	Anëtar i “““
Zija Vuci	Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalice, në datën 19.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.100 Akti që i përket:

Kërkuese: Saemira Gjipali, kandidate për deputete e Partisë Socialiste, përfaqësuar me prokurë nga avokat Arben Hakani.

Subjekte të interesuara:

Komisioni Qendror i zgjedhjeve, përfaqësuar nga Sokol Lamaj.

Spartak Ngjela, përfaqësuar me autorizim nga Vladimir Mulaj.

Komisioni i zonës zgjedhore nr.38, përfaqësuar nga zëvendëskryetari Tonin Alimëhilli.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.163, datë 17.7.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe shpallja e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në këtë zonë.

Baza ligjore: Nenet 131 shkronja “e” e Kushtetutës; 141 pika 1; 113 shkronja “a” dhe pika 5 e Kodit Zgjedhor.

Kërkesja Saemira Gjipali ka kërkuar shfuqizimin e vendimit të sipërpërmendur për këto shkaqe:

- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, duke marrë vendim për futjen në listat e zgjedhësve të 768 personave një ditë përpara zgjedhjeve të datës 24.6.2001, ka vepruar në kundërshtim me nenin 56 të Kodit Zgjedhor sepse kjo e drejtë i takon gjykatës dhe jo atij.

- Në qendrat e votimit nr.255, 257, 258 dhe 258/1 janë lejuar të votojnë persona me certifikata të parregullta që nuk përbejnë kërkesat e dokumenteve të identifikimit.

- Nga verifikimet që janë bërë del se 61 persona janë të regjistruar në dy qendra votimi, ndonëse në asnjërën prej tyre nuk kishin të drejtë të votonin, prandaj pavlefshmëria e votave të tyre duhet të shpallet për dyfishin e tyre d.m.th. për 24 vota, ku përfshihet edhe rasti i një zgjedhësi që ka votuar me certifikatë pa qenë i regjistruar në listën e zgjedhësve.

- Në qendrën e votimit nr. 274 janë mbyllur votimet shumë kohë përpara orës 18.00, duke u justifikuar ky veprim me deklaratat që kanë lëshuar disa të burgosur se nuk donin të votonin. Në këtë mënyrë, sipas listës kanë mbetur 21 persona pa votuar.

- Po kështu, edhe në qendrën e votimit nr. 274/1 që është hapur në burgun tjetër del se në raundin e dytë të zgjedhjeve janë shtuar në lista zgjedhës të rinj pa vendim gjykatë.

- Në shumë qendra të tjera votimi janë pranuar të votojnë zgjedhës me certifikata të parregullta, që për shkak të mangësive nuk janë dokumente të mirëfilltë identifikimi.

- Në këto rrethana kërkesja këmbëngul për shfuqizimin e vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në krejt zonën.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Zija Vuci, përfaqësuesin e kërkuesses, subjektet e interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N :

Në raundin e dytë të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të zhvilluar në datën 8.7.2001 Komisioni i Zonës Zgjedhore nr.38 për qytetin e Tiranës ka shpallur fitues kandidatin e pavarur për deputet zotin Spartak Ngjela. Kjo zgjidhje është miratuar edhe nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 163, datë 10.7.2001.

Kundër këtij vendimi ka bërë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese kandidatja e Partisë Socialiste zonja Saemira Gjipali, e cila ka humbur në këto zgjedhje duke realizuar 246 vota më pak se zoti Spartak Ngjela.

Pretendimet e saj për shfuqizimin e vendimit të sipërpërmendur dhe për përsëritjen e zgjedhjeve në këtë zonë Gjykata Kushtetuese i gjen të pabazuara. Kjo, duke filluar analizën e tyre nga 748 zgjedhësit që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.911, datë 23.4.2001, ka vendosur të përfshihen në listën e zgjedhësve të Komisionit Zonal të Qendrës së Votimit nr.9 në Tiranë për listat 3 dhe 3/13 arrin në përfundim se një veprim i tillë nuk përbën shkelje në vështrim të nenit 56 të Kodit Zgjedhor.

Nga përmbajtja e këtij vendimi, si dhe pjesa arsyetuese e vendimit nr. 84, datë 6.7.2001 të Gjykatës së Apelit të Tiranës rezulton se mospërfshirja në listën elektorale të këtyre zgjedhësve është thjesht një ometim ose gabim teknik i Qendrës së Informatizimit Financiar, fakt i cili provohet edhe me vërtetimin që kjo e fundit ka lëshuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Në këto rrethana që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka ndrequr këtë gabim ka vepruar brenda kompetencave të veta të parashikuara nga neni 18 pika 1 të Kodit Zgjedhor. Ndreja e këtij gabimi nuk është shoqëruar me shtesa ose ndryshime në listat paraprake të zgjedhësve, por vetëm saktësimin e tyre, prandaj ndryshe nga sa pretenduar e kërkuessa, zgjidhja e kësaj çështjeje nuk hyn në juridiksionin gjyqësor për të cilin bëhet fjalë në nenin 56 paragrafi i dytë dhe 143 të Kodit Zgjedhor.

Ky pretendim i saj është i papranueshëm edhe për faktin se, siç doli gjatë gjykimit, vendimi nr.911, datë 23.6.2001 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka filluar të prodhojë efektet e veta që në raundin e parë të zgjedhjeve, por komisionet e këtyre qendrave të votimit nuk kanë bërë vërejtjet përkatëse për përmbajtjen e tij. Po kështu as kërkuessa, as përfaqësuesi i saj nuk kanë ushtruar të drejtën e ankimit brenda afatit ligjor i cili ka filluar të ecë nga dita që është shpallur balotazhi midis saj dhe subjektit të interesuar, Spartak Ngjela.

Të pabazuara janë edhe pretendimet e tjera që ka parashtruar kërkuessa, 61 zgjedhësit që ajo ka pretenduar se në datën 8.7.2001 kanë votuar në dy qendra votimi të zonës zgjedhore nr.38 dhe që pavlefshmëria e këtyre votave sipas saj duhet të llogariten me dyfishin për shkak se këta zgjedhës nuk duhej të ishin përfshirë në listat e zgjedhësve, mbetet një çështje pjesërisht e paprovuar dhe pjesërisht

e pabazuar.

Vetë kërkesja nuk ka paraqitur prova bindëse për të rrëzuar përmbajtjen e këtyre dokumenteve zyrtare. Madje emrat e këtyre zgjedhësve që ajo pretendon se figurojnë në lista të qendrave të ndryshme të votimit nuk përputhen plotësisht midis tyre. Nga verifikimi dhe krahasimi i një pjese të këtyre listave, vërehen ndryshime nga njera listë në tjetrën. Këto ndryshime kanë të bëjnë kryesisht me emrin, atësinë, mbiemrin ose datëlindjen e këtyre zgjedhësve.

Nga ana tjetër, edhe nëqoftë se është e vërtetë që këta zgjedhës janë të njëjtë, persona që janë të regjistruar në listat e shpallura, në dy qendra votimi, kërkesja nuk paraqiti asnjë provë për të vërtetuar se vota e tyre është hedhur në të dyja këto qendra votimi.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese nuk mund të dalë me konkluzion kategorik mbi vërtetësinë ose jo të këtyre pretendimeve.

Ajo nuk është e detyruar dhe është jashtë kompetencave të saj të kontrollojë një për një dhe emër për emër të gjitha listat e përdorura në këto qendra votimi, të verifikojë dhe të konkludojë nëse në dy nga këto lista ka nënshkruar i njëjti person apo persona të ndryshëm.

Kryerja e veprimeve të kësaj natyre në kuadrin e kontrollit kushtetues praktikisht është e paralizueshme. Jo vetëm kaq, por në kërkesë pretendohet për falsifikime ose shkelje të tjera të Kodit Zgjedhor që përmbajnë elementë të veprave penale të parashikuara nga nenet 335 e vijues të Kodit Penal. Evidentimi ose zbardhja e këtyre fenomeneve nuk është atribut i Gjykatës Kushtetues por kompetencë ekskluzive e organeve të ndjekjes penale.

Të njëjtin qëndrim mban Gjykata edhe përsa i përket pretendimit të kërkeses në lidhje me dokumentet e identifikimit që kanë përdorur disa nga zgjedhësit me rastin e votimit.

Parregullsia e pretenduar prej saj e këtyre dokumenteve ose e certifikatave nuk vërtetohet me provat që ndodhen në dosje. Me një certifikatë që ka paraqitur ajo si provë nuk mund të dilet me konkluzionin se të gjitha certifikatat me të cilat janë identifikuar zgjedhësit e tjerë, janë njëloj si e para të parregullta. Kjo edhe për arsye se të gjitha këto dokumente i janë nënshtruar kontrollit paraprak të komisionerëve të qendrave të votimit, shumica e të cilëve kanë qenë të caktuar nga subjekti politik që ka mbështetur kërkesen ose nga partitë e tjera aleate.

Për më tepër, asnjëri nga këta komisionerë nuk ka bërë vërejtje në procesverbalet e këtyre qendrave të votimit lidhur me këtë shkelje të pretenduar prandaj edhe kjo pjesë e kërkesës duhet rrëzuar si e paprovuar.

Duhet rrëzuar gjithashtu por për shkaqe të tjera edhe kërkesa për pavlefshmëri të zgjedhjeve në qendrat e votimit nr.174 dhe 274/1 të ngritura respektivisht në burgjet 302 e 303 të Tiranës.

Është e vërtetë se në këto njësi zgjedhore janë vërtetuar shkelje të Kodit Zgjedhor, sepse në njerën është mbyllur votimi përpara orës 18.00, kurse në tjetrën ka pasur ndryshime në listat e zgjedhësve për shkak të arrestimeve ose të lirimeve që kanë ndodhur midis raundit të parë dhe të dytë të zgjedhjeve, por këto parregullsi janë të papërfillshme dhe nuk ndikojnë në rezultatin që e shpall fitues kandidatin e pavarur Spartak Ngjela.

Kështu nga procesverbalet e këtyre qendrave të votimit del se edhe sikur të gjithë zgjedhësit që nuk kanë votuar të votonin për kërkesen ose votat e atyre që kanë votuar pa të drejtë të shpalleshin të pavlefshme përsëri kjo nuk ndikon në rezultatin e shpallur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 shkronja “e” dhe 132 të Kushtetutës, në nenet 26 dhe 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 114 pika 5 të Kodit Zgjedhor, me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

MENDIMI I PAKICËS

Pa asnjë mëdyshje, duke mbetur kundër vendimit të shumicës, për shkak se problemi që trajtohet është më tepër çështje konceptuale e trajtimit teoriko-doktrinar, sesa çështje e të provuarit, po përpiqem të argumentoj arsyet e të qenit në oponencë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në datën 23 qershor 2001, me kërkesën dhe insistimin e kandidatit për deputet të koalicionit “Bashkimi për Fitore” Spartak Ngjela, ka vendosur të përfshijë në listat përfundimtare të zgjedhësve të zonës zgjedhore nr.38, një numër prej 768 personash, si rekorde me status “P” dhe “L” që përsëriteshin vetëm një herë.

Shumica, në vendimin e saj, e motivon marrjen e këtij vendimi nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve si ndreqje të gabimit material, ndërkohë që vetë ky organ nuk e ka parashtruar këtë argument.

Ky vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në aspektin formalo-juridik nuk është një ndreqje gabimi material, por një akt administrativ me një përmbajtje krejtësisht të re. Çështja e gabimit material në një akt administrativ lidhet më tepër me pasaktësi të karakterit redaksional, si gabime daktilografimi, llogaritje gabim të dhënash, shifrash ose mangësi në kuptimin e harresës, apo të lënies pas dore të ndonjë fjale etj.

Në të gjitha këto raste ndreqja ose korrigjimi nuk sjellin si pasojë nxjerrjen e ndonjë akti të ri, sepse akti që e përmban një gabim të tillë ekziston që nga momenti që ai është nxjerrë. Akti administrativ që përmban gabime apo pasaktësi të dukshme sigurisht që mund të korrigjohet nga organi që e ka nxjerrë, por në çdo rast korrigjimi apo ndreqja e pasaktësisë nuk duhet të prekë përmbajtjen e aktit.

Ky vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke shtuar 768 persona pa asnjë lloj shkak ligjor dhe prove për korrigjim, ka prekur në të vërtetë përmbajtjen e aktit, pra të listave ekzistuese të zgjedhësve. Mjafton ky fakt që veprimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të mos komentohet si ndreqje gabimi material. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pa kryer asnjë hetim procedural në kuptimin administrativ, pa verifikuar faktin me ndonjë dokument shkresor nga zyra e gjendjes civile, se këta persona nuk ishin të vdekur ose nuk ishin të larguar përgjithmonë nga kjo zonë zgjedhore, e ka pranuar pa asnjë kufizim regjistrimin e tyre.

Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, sepse nuk është nxjerrë nga organi kompetent. Një nga kushtet për të qenë akti i vlefshëm është kompetenca e organit. Sipas nenit 56 të Kodit Zgjedhor, është KZQV-ja organi i ngarkuar nga ligji për të hartuar listat e zgjedhësve, i cili nuk mund të bëjë asnjë ndryshim në listat paraprake të zgjedhësve gjatë 23 ditëve të fundit para datës së zgjedhjeve, Kjo dispozitë ligjore ndalon KZQV-në, aq më tepër Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për të ndryshuar listat e zgjedhësve.

Çështja e rregullimit të pasaktësive në listat e zgjedhësve, apo e korrigjimit të tyre para datës së zgjedhjeve nuk hyn në juridiksionin administrativ të asnjë komisioni zgjedhor. Kjo çështje në këtë afat 23 ditor parazgjedhor del nga juridiksioni administrativ dhe bëhet pjesë e juridiksionit gjyqësor. Pikërisht për arsye të një ometimi ligjor në këtë drejtim, ligjvënësi u detyrua që me ligjin nr. 8780, datë 3.5.2001 të bëjë një shtesë në nenin 56 të Kodit Zgjedhor, në të cilin parashikohet e drejta e shtetasve për t’iu drejtuar gjykatës, kur vërenin se nuk figuronin të regjistruar në listat e zgjedhësve. Në këto raste zgjedhësi është i detyruar të paraqesë në gjykatë certifikatën e lindjes së gjendjes civile, vërtetimin e njësisë përkatëse të organit të pushtetit vendor ku ai ka vendqendrimin e tij dhe vërtetimin nga KZZ-ja ose KZQV-ja, të cilët deklarojnë se zgjedhësi nuk është i regjistruar në listën e zgjedhësve të zonës. Këto janë dokumente të rëndësishme mbi të cilat bindet gjykata për të kryer regjistrimin.

Në kundërshtim me këtë ligj dhe me procedurën që ndiqet në këto raste Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka regjistruar 768 persona, ndërkohë që ajo nuk ka disponuar anjë dokument që të konfirmojë vërtetësinë e këtij regjistrimi.

Në këto kushte vendimi i Komisionit Qendror i Zgjedhjeve, duke qenë një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk është e nevojshme që të shfuqizohet nëpërmjet ndonjë padie të veçantë. Neni 121 i Kodit të Procedurave Administrative e trajton këtë moment. Nuliteti nuk mund të shfuqizohet, por vetëm konstatohet si i tillë për efekt të rregullimit të pasojave nga gjykata ose çdo organ tjetër që ndeshet me të në çdo kohë. Nuliteti i aktit nuk mund të lidhet me asnjë afat parashkrimi, siç arsyeton gabimisht Gjykata e Apelit në vendimin e saj kur ka vendosur rrëzimin e padisë së ngritur nga kërkuësja për shkak të kalimit të afatit.

Pikërisht karakterin absolutisht të pavlefshëm të vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve lidhur me shtimin arbitrarisht të 768 personave në listat e zgjedhësve duhej ta konstatonte Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj. Ky nulitet i vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve përbën një shkelje mjaft të rëndë të ligjit, e cila ndikon drejtpërdrejtë në rezultatin e zgjedhjeve, sepse diferenca ndërmjet kandidatëve është 246 vota. Ishte i mjaftueshëm ky fakt që Gjykata Kushtetuese të shpallte pavlefshmërinë e zgjedhjeve në të gjithë zonën zgjedhore nr.38 dhe përsëritjen e tyre. Numri prej 768 personash duhej të çregjistrohej nga listat e zgjedhësve si persona të regjistruar në mënyrë të kundërligjshme dhe nëse këta shtetas dëshironin të ushtronin të drejtën e votës duhej të ndiqnin rrugën ligjore që parashikon neni 56 i ndryshuar i Kodit Zgjedhor, duke iu drejtuar gjykatës.

Mbi bazën e të gjithë argumenteve që sipërcitova, mendoj se kërkesa e kandidatës për deputete Saemira Gjipali ishte e bazuar në ligj dhe duhej pranuar.

ANËTAR
av. Sokol Sadushi

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 21.8.2001
Doli nga shtypi më 24.8.2001

Tirazhi: 4100 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “At Gjergj Fishta” sh.p.k.
Tiranë, 2001

Çmimi: 150 lekë